Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Dalës - Dalëse - Izlazni - Outgoing
02 No.Nr. 44-26
Tarih/Dt. 20.02.2026

02 Nr 44 /26
Me 20.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M
Për ndryshimin në Listën e Pagave

Neni 1

Z. Ramadan Mazreku, me Vendimin nr. 02.Nr.133/25, të datës 17.11.2025, ka qenë caktuar Ushtrues Detyre në pozitën e Drejtorit të QKMF-së Mamushë , për një periudhë tre (3) mujajsh, pas përfundimit të kohës së caktimit si Ushtues Detyere në **pozitën e** Drejtorit të QKMF-së Mamushë, i njëjti kthehet në pozitën e më parshme të asaj të Mjekut të Përgjithshëm në Qendrën Kreyesore të Mjekësisë familjare në Komunën e Mamushës.

Neni 2

Obligohet- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Socoale në Komunën e Mamushës që për të lartcekurin të përcjellë dokumentacionin përkatës në Thesarin e Kosovës – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me qëllim të ndryshimit në Listën e Pagave, në bazë të këtij vendimit duke bërë ndryshim në liste të pagave nga pozita U.D pozitën e Drejtorit të QKMF-së Mamushë në pozitën e mëparshme mjek i përgjithshëm.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 Nr. 43-26
Tarih/Dt. 20.02.2026

02 Nr. 43 -26
Me 20.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 53 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publikë, nenit 82.7 të Statutit të Komunës së Mamushë të datës 01.12.2008 ,Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për shfuqzimin e Vendimit 02-233-25 të datës 17.11.2025

I

Shfuqizohet- Vendimi me nr. 02-233/25 të datës 17.11.2025, për caktimin Z. Ramadan Mazreku, Ushtrues Detyre në pozitën e Drejtorit të QKMF-së Mamushë

II

Z. Ramadan Mazreku sipas vendimit të lartëcekur pikës II kthehet në pozitën e më parshme.

III

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Kryetarit të Komunës .

A R S Y E T I M

z. Ramadan Mazreku, ishte caktuar Ushtrues Detyre në pozitën e Drejtorit të QKMF-së Mamushë , për shkak të mungesës së Drejtorit të QKMF-së Mamushë, në periudhë prej 3 gjashtë muaj. Andaj pas përfundimit të kohëzgjatjes së vendimit për caktimin si ushtrues detyre, i njëti kthehet në pozitën e mëparshme si Mjek i Përgjithshëm në Qendrën Kryesore të Mjekësië familjare në Komunën e Mamushës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Z. Ramadan Mazreku
2. DSHMS
3. Personeli
4. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 No.Nr. 42-26
20.02.2026

02 Nr. 42 /26
Me 20.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug 02/Nr.68/24 e datës 02.10.2024, Raportin e Agjencisë për zhvillim Rajonal Jug e datës 16.07.2025 dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Për pagesën Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Komuna e Mamushës dhe OJQ Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug

Neni 1

Komuna e Mamushës dhe Agjencia për Zhvillim Rajonal Jug kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim të zbatimit të politikave të zhvillimit rajonal me qëllim të krijimit të vendeve të punës në Komunën e Mamushës dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore lokale të Komunës së Mamushës përmes projekteve të financuara nga burimet e brendshme dhe të jashtme.

Neni 2

Bazuar në Memorandumin me nr. të protokollit 02/Nr-69-25 i datës 20.10.2025 përgjegjësitë e Komunës së Mamushës janë ta parapara në këtë Memorandum, gjegjësisht në nenin 3 paragrafi 3.2, ku si obligim e palëve të përcaktuar në këtë nen theksohet se Komuna e Mamushës financon projektin në fjalë.

Neni 3

Mjetet që lejohen në shumën prej 3,820.00 € sipas Raportin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal Jug e datës 20.02.2026, pagesa për periudhën e muajit shkurt 2026, sipas numrit të zotimit 2026-20675.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim të njoftohet

1. Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
2. Palëve
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çikiş - Dalëse - Outgoing
02 N.N. 41-26
Tarih/Dt. 19.02.2026

ZYRA E KRYETARIT
02. Nr. 41 -25
Me datë: 19.02.2026
Komuna e Mamushës

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, lidhur me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 të Rregullores (QRK) nr. 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, si dhe nenit 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

Për ri-emërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në Pozitën e Drejtorit të SH.F.M.U "ANADOLU"

Neni I

z. Erol Morina caktohet Ushtrues Detyre Drejtor të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "ANADOLU" në Komunën e Mamushës për një afat prej gjashtë (6) muajsh, duke filluar nga data 20.02.2026 deri më 20.08.2026.

Neni II

Obligohet Zyra e Personelit që brenda afatit ligjor të shpallë konkurs të ri për rekrutimin në pozitën e drejtorit të SH.F.M.U "ANADOLU" në Komunën e Mamushës.

Neni III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Drejtoria e Arsimit Rinisë, Kulturës dhe Sportit të Komunës së Mamushës, ka bërë Kërkesë për ri-emërimin e z. Erol Morina U.D Drejtor të Shkollës Fillore të mesme të ulët **ANADOLU**, i njëjti ka qenë i caktuar si U.D Drejtor i Shkollës Fillore me vendim, andaj, ri-emërohet edhe për një afat prej gjashtë (6) muajsh, duke filluar nga data 20.02.2026 deri më 20.08.2026.

Ri-emërim i U.D drejtorit të shkollës është caktuar për shkak të përfundimit të kontratës, së drejtorit të shkollës përkatëse dhe dështimit në Konkursin e hapur. Andaj, në mungesë të pozitës së Drejtorit të Shkollës Fillore të mesme të ulët **ANADOLU** z. Erol Morinës i vazhdohet vendimi konform kërkesës së DKA-së për caktimin si U.D Drejtor i Shkollës deri në përfundim të procedurave të përzgjedhjes së Drejtorit të Shkollës me Konkurs.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës të parashtruar nga e Drejtorisë së Arsimit pranë Komunës së Mamushës për ri-emërimin e Drejtorit të Shkollës fillore në Komunën e Mamushës e njëjta është aprovuar duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vendimi për caktimin e U.D Drejtorit të Shkollës Fillore të mesme të ulët **ANADOLU** pranë Komunës së Mamushës është vazhduar konform Rregullore (QRK) nr:19/2024 për Procedurat e

Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar.

Emërimi i përkohshëm i drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës bëhet nga subjektet që kanë përgjegjësi për emërimin me mandat të plotë të kandidatëve për këto pozita, Emërimi i përkohshëm i drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës bëhet kur: ***Vendi i punës i drejtorit/eshës, zëvendësdrejtorit/eshës shpallet i lirë dhe emërimi i përkohshëm në raste të tilla bëhet deri në kryerjen e procedurave ligjore për përzgjedhjen e drejtorit/eshës, zëvendësdrejtorit/eshës të/së IEAA-AP të përcaktuara me këtë Rregullore.***

Andaj është vendosur si në diapozitivin e këtij vendimi.

Për të gjitha arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:
- DKA
- Z. Erol Morina
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No. 90-25
Tarih/Dt. 19.02.2026

ZYRA E KRYETARIT
02. Nr. 90 -25
Me datë: 19.02.2026
Komuna e Mamushës

Në bazë të neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr..03./-040, lidhur me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.2 Udhëzim Administrativ (shëndetsi) nr. 04/2020 Kujdesi Paresor Shendetesor lidhur me nenin 26 dhe 27 të Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 82.6 të Statutit të Komunës së Mamushës, datës 01.12.2008, Kryetari i Komunës bie këtë vendim.

VENDIM

Për riemërimin e përkohshëm si Ushtrues Detyre në pozitën e Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë

NENI I

z. Mirat Morina, caktohet Ushtrues Detyre në pozitën e Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë prej nje afat prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data 17.02.2026 deri më 17.08.2026.

NENI II

OBLIGOHET: Zyra e Personelit që, brenda afatit ligjor, të shpallë konkurs për rekrutimin e pozitës së Kryeinfermierit të QKMF-së në Komunën e Mamushës.

NENI III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

z. Mirat Morina është si Ushtrues Detyre (U.D.) i Kryeinfermierit të QKMF-së në Mamushë, i njëjti ka qenë i caktuar më herët në këtë detyrë dhe, me kërkesën me nr. protokolli 02.Nr.72-25, të datës 17.11.2025, por përshkak të mos përfundim të procedura të konkursit pët këtë pozitë dhe nevojës institucionle që kjo pozitë të mos mbetet e zbrazët i njëjtë caktohet edhe për një afat prej 6 muajsh duke filluar nga data 17.02.2026 deri më 17.08.2026.

Riemërimi i Kryeinfermierit të QKMF-së Mamushë është bërë për shkak të mungesës së një kryeinfermieri të përhershëm në këtë institucion. Z. Mirat Morinës i vazhdohet vendimi konform kërkesës së DSHMS-së për caktimin si Kryeinfermier i QKMF-së në Mamushë deri në përfundimin e procedurave përzgjedhëse për Kryeinfermierin e rregullt.

Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale pranë Komunës së Mamushës për riemërimin e Kryeinfermierit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës, e njëjta është aprovuar, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Vendimi për caktimin e Kryeinfermierit të QKMF-së në Komunën e Mamushës është vazhduar konform Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) nr. 04/2020 për Kujdesin Parësor Shëndetësor.

Duke marrë parasysh rolin dhe funksionimin e QKMF-së, si dhe rolin e Kryeinfermierit në këtë institucion shëndetësor parësor, është vlerësuar se të njëjtit duhet t'i vazhdohet vendimi si Kryeinfermier i QKMF-së në Mamushë deri në përfundimin e të gjitha procedurave të konkursit të rregullt dhe publik.

Andaj është vendosur si në diapozitivin e këtij vendimi.

Njoftohen:

- DSHMS
- Z. Mirat Morina
- Zyra e Personelit
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamuşa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamuşa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
No.Nr. 39
Tarih/Dt. 13.02.2026

02 Nr. 39 /26
Me 13.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për pagesën e Kontrollit Teknik
Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik KRASNIQI N.P.SH (Zenel Krasniqi B.I), sipas fletëpagesës nr. **0603/26**, për shërbimin e kontrollit teknik të automjetit të tipit ISUSU URBAN4H 6.1 me targa 04Z-12-32, me numër të shasisë KZN18500666495

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria "Mallra dhe Shërbime", sipas përshkrimit, "Kontrolli Teknik" i Automjetit ISUSU URBAN4H 6.1 me targa 04Z-12-32, me numër të shasisë KZN18500666495" në shumën 45.00 €, sipas bllokut kodues: 10/626/16314/13954/00000/0133 dhe sipas zotimit 2026-18152, për përfituesin: KRASNIQI N.P.SH (Zenel Krasniqi B.I) Numri unik i biznesit: **810630774**, Llogaria bankare 1502040000518539.

ARSYETIM

Automjetet që janë në shfrytëzim nga institucionet komunale duhet t'i nënshtrohen rregullisht kontrollit teknik, në përputhje me dispozitat ligjore për sigurinë në komunikacion dhe funksionalitetin teknik të mjeteve motorike. Automjeti i tipit ISUSU URBAN4H 6.1 me targa 04Z-12-32, me numër të shasisë KZN18500666495, është pjesë e automjeteve zyrtare Komunës së Mamushës që është në shërbim të Komunës së Mamushës. Kryerja e kontrollit teknik është obligim ligjor dhe parakusht për regjistrimin dhe qarkullimin e ligjshëm të automjetit, andaj realizimi i pagesës për këtë shërbim është i domosdoshëm dhe urgjent.

Për këto arsye, është marrë vendimi për lejimin e mjeteve financiare në shumën përkatëse, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtoria e Administratës
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 Nr. 38 /26
Me 13.02.2026
Mamushë

Republika Kosova-Republika Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Cikus - Dalje - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 38-12
Tarih/Dt. 13.02.2026

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për pagesën e Kontrollit Teknik
Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik KRASNIQI N.P.SH (Zenel Krasniqi B.I), sipas fletëpagesës nr. **0574/26**, për shërbimin e kontrollit teknik të automjetit të tipit Toyota 4x4 RUNER 3.0 me targa 04Z-08-32, me numër të shasisë NNAMGB5LL02012.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria "Mallra dhe Shërbime", sipas përshkrimit, "Kontrolli Teknik" i Automjetit Toyota 4x4 RUNER 3.0, dhe targa 04Z-08-32, me numër të shasisë NNAMGB5LL02012" në shumën 30.00 €, sipas bllokut kodues: 10/626/16314/13954/00000/0133 dhe sipas zotimit 2026-17977, për përfituesin: KRASNIQI N.P.SH (Zenel Krasniqi B.I) Numri unik i biznesit: **810630774**, Llogaria bankare 1502040000518539.

ARSYETIM

Automjetet që janë në shfrytëzim nga institucionet komunale duhet t'i nënshtrohen rregullisht kontrollit teknik, në përputhje me dispozitat ligjore për sigurinë në komunikacion dhe funksionalitetin teknik të mjeteve motorike. Automjeti i tipit Toyota 4x4 RUNER 3.0 me targa 04Z-08-32 dhe , me numër të shasisë NNAMGB5LL02012, është pjesë e automjeteve zyrtare Komunës së Mamushës që është në shërbim të Komunës së Mamushës. Kryerja e kontrollit teknik është obligim ligjor dhe parakusht për regjistrimin dhe qarkullimin e ligjshëm të automjetit, andaj realizimi i pagesës për këtë shërbim është i domosdoshëm dhe urgjent.

Për këto arsye, është marrë vendimi për lejimin e mjeteve financiare në shumën përkatëse, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtoria e Administratës
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA E MAMUSHËS - MAMUŞA BELEDİYESİ - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPALITY OF MAMUSA - 2005

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
MAMUŞA BELEDİYESI - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA - MUNICIPAL OF MAMUSA

Zyra e Kryetarit
02 Nr. 37/26
Me 12. 02 2026

Çikiş - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 37-26
Tarih/Dt. 12. 02. 2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 40, paragrafi 1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës) NR.21/18 shtator 2023 , lidhur me nenin 12, paragrafi 1 dhe 3, pika 3.1, 3.2 dhe 3.3 Rregullore (QRK) NR. 30/2024 Për Procedurën E Pranimit të nëpunësve në Shërbimin Publik në Sektorin e Shëndetësisë, nenit 44, 45 dhe 46 të Ligjit i nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

VENDIM

Komisioni i pranimit për pozitat të kategorisë profesionale për Mjekë të Përgjithshëm

Neni I

Formohet: Komisioni për zhvillimin e procedurave për pranim në shërbim publik në pozitën të kategorisë profesionale në Komunën e Mamushës.

Neni II

Komisioni i Pranimit në pajtim me neni I të këtij neni përbëhet nga:

1. znj. Fitore Bytuçi- U.D Kryesuese Menaxhere e personelit
2. z. Ramadan Mazreku - anëtarë Shef i QKMF-së
3. z. Mirat Morina - anëtar- Udhëheqës i Sektorit në QKMF
4. znj. Bilay Kazaz –anëtare- Mjeke e Përgjithshme
5. znj. Arzu Orçuşa – anëtare- Mjeke e Përgjithshme

Neni III

Komisioni i pranimit si në pikën II ka mandat 2 vjeçar, nga dita e nënshkrimit të këtij vendimit, me mundësi të ripërtëritjes sipas nevojës.

Neni IV

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Ligjit NR.08/L-197 për zyrtar publik dhe Rregullore (QRK) NR. 30/2024 Për Procedurën e Pranimit të nëpunësve në Shërbimin Publik në Sektorin e Shëndetësisë.

Kryetar i Komunës së Mamushës

Abdülhadi KRASNIÇ

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Outgoing
02 No.Nr. 36-26
Tarih/Dt. 10. 02 2026

02 Nr. 36/26
Me 10. 02 2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/l-212 i Punës, Vendimi me numër të Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M
Për ndryshimin në Listë të Pagave

Neni 1

z. Labinot Muhaxheri, është transferuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Mamushës, në bazë të vendimit Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil të marrë nga Kryetari i Komunës së Mamushës, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me nevojat organizative të institucionit.

Neni 2

Obligohet- Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurën ta përcjell dokumentacionin tek Thesari i Kosovës, Ministria e Financave (MFPT), me qëllim të ndryshimit në listë të pagave në bazë të Aktemërim kategorisë Profesional 1, sipas koeficientit 6.56 (Klasa GJ32 sipas LigjitNr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

z.Labinot Muhaxheri, i cili deri më tani ka ushtruar funksionin e Inspektorit të Tregut në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike pas vlerësimit të nevojave profesionale dhe organizative brenda institucionit, si dhe në përputhje me procedurat ligjore dhe administrative, është sistemuar në pozitën e re të Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë, brenda të njëjtit institucion në Komunën e Mamushës. Ky transferim paraqet një lëvizje të brendshme që synon rritjen e kapaciteteve profesionale në menaxhimin të punëve në ktë drejtori.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazni - Outgoing
02 No.Nr. 35-26
Tarih/Dt. 10.02.2026

02 Nr. 35**-26**
Datë 10.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 21 Ligji nr. 08/l-197 për Zyrtarët Publik, nenit 9 paragrafi 9 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik lidhur me nenin 32 paragrafi 9 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, neni 44, 45, 46 të Ligji nr. 05/l -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative statutit te Komunës së Mamushë, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR KOMPENSIMIN E DITËVE TË PASHFRYTËZUARA TË PUSHIMIT VJETOR

Neni 1

Nëpunësit civil, z. Gazmend Gashi, me numër personal [redacted], i miratohet kompensimi financiar për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor për vitet 2025 dhe 2026, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Pagesa e këtij kompensimi do të realizohet brenda afatit ligjor, pas miratimit të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.

Neni 2

Numri i ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor për vitet 2025 dhe 2026 është gjithsej 42 (dyzet e dy) ditë pune. Kompensimi financiar për këto ditë llogaritet në bazë të pagës bazë mujore të nëpunësit, të ndarë proporcionalisht sipas numrit të ditëve të punës, në shumën prej 1,276.54 euro.

Neni 3

Kompensimi financiar i ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor realizohet në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe trajtimin e të drejtave të punonjësve në këto raste.

Neni 4

Obligohet- Zyra e Personelit që dokumentacionin përkatës për personin e lartcekur ta përcjellë në Thesarin e Kosovës, pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me qëllim të realizimit të pagesës së kompensimit financiar në shumën prej 1,276.54 euro, pas miratimit të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, përkatësisht pas sigurimit të mjeteve buxhetore.

Neni 5

Pagesa e kompensimit financiar sipas këtij vendimi nuk do të realizohet në këtë periudhë, por pas miratimit të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe sigurimit të mjeteve buxhetore përkatëse. Kjo për shkak se institucioni aktualisht funksionon me financim të

përkohshëm 1/12 të buxhetit, ndërsa programi buxhetor 16014, në kuadër të të cilit është i sistemuar nëpunësi në listën e pagave, rezulton me mungesë mjetesh, çka do të rrezikonte pagesën e pagave bazë të të punësuarve.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Nga verifikimi i kryer nga Zyra e Personelit është konstatuar se nëpunësi civil, z. Gazmend Gashi, nuk ka arritur t'i shfrytëzojë ditët e pushimit vjetor për vitet 2025 dhe 2026, pavarësisht të drejtës së tij ligjore, për shkak të ngarkesës së shtuar në punë dhe kryerjes së detyrave të domosdoshme në interes të shërbimit publik.

Marrëdhënia e punës me nëpunësin civil në fjalë ndërpritet më datë 15.02.2026, për shkak të dorëheqjes së tij. Kjo rrethanë përbën bazë të plotë ligjore për kompensimin financiar të ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor, në përputhje me nenin 9, paragrafi 9 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, si dhe me nenin 32, paragrafi 9 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Megjithatë, në bazë të njoftimit të pranuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përcakton se asnjë obligim financiar nuk mund të krijohet pa autorizim ligjor dhe pa buxhet të aprovuar, ndërsa zyrtarët përgjegjës të organizatave buxhetore mbajnë përgjegjësi ligjore për menaxhimin e rregullt dhe të përgjegjshëm të mjeteve publike.

Po ashtu, në përputhje me nenin 5 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, mjetet financiare për paga, shtesa, shpërblime dhe kompensime të tjera për të punësuarit sigurohen ekskluzivisht përmes Buxhetit të Republikës së Kosovës. Çdo vendim për miratim apo pagesë të kompensimeve pa buxhet të aprovuar përbën shkelje të dispozitave ligjore në fuqi.

Gjithashtu, Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal obligon komunat që, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, të zbatojnë plotësisht legjislacionin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Për këto arsye, me këtë vendim aprovohet e drejta për kompensimin financiar të ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor, ndërsa realizimi i pagesës do të bëhet pas miratimit të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe sigurimit të mjeteve buxhetore, me qëllim të respektimit të disiplinës financiare dhe legjislacionit në fuqi.

- Z. Gazmend Gashi
- NJMBNJ
- Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdulhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Giriş - Dalese - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 34-26
Tarih/Dt. 10.02.2026

02Nr.34-26
Me 10.02.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Neni 11 Rregullore (QRK) nr. 02/2024 Për Transferimin e Nëpunësve Civilë, lidhur me nenin 44, 45, 46 dhe 48 të Ligji nr. 05/l -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe neni 82 të Statutit të Komunës së Mamushës.

VENDIM
Për transferimin e përhershëm të nëpunësit Civil

Neni 1
z.Labinot Muhaxheri nga pozita Inspektor i Tregut në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, transferohet në Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Mamushës.

Neni 2
Vendimi i ri i punës është i kategorisë Profesional 1, sipas koeficientit 6.56 (Klasa GJ32 sipas LigjitNr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).

Neni 3
Nëpunësi fillon punën si Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Mamushës nga data 10.02.2026.

Neni 4
Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që brenda afatit Ligjor ta bëjë përditësimin në Aktemërimin e nëpunësit civil.

Neni 5
Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Mamushës.

ARSYETIM

z.**Labinot Muhaxheri**, i punësuar në vendin e punës Inspektor i Tregut në Komunën e Mamushës, transferohet në pozitën Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Mamushës, për shkak të nevojës institucionale për sigurimin e ushtrimit të pandërprerë të funksionit të kësaj Drejtorie.

Kjo nevojë ka lindur për faktin se Drejtoria e Bujqësisë aktualisht nuk ka asnjë zyrtar, pasi që zyrtari i vetëm ka dalë në pension të parakohshëm dhe kjo drejtori ka mbetur pa zyrtar, gjë që krijon vështirësi në kryerjen e punëve të përditshme.

Ky transferim bëhet në funksion dhe në interes të institucionit, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së proceseve lidhur me Drejtorinë e Bujqësisë në Komunën e Mamushës.

Transferimi i nëpunësit civil bëhet me pajtimin e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, të udhëheqësit më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit, në mënyrë të përhershme, në një vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, brenda së njëjtës kategori të shërbimit civil, me kusht që përgatitja profesionale e tij të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet.

Duke u bazuar në të gjitha sa më sipër dhe në interes të institucionit, Kryetari i Komunës konstaton se transferimi i përhershëm i z.Labinot Muhaxheri është i arsyeshëm dhe i nevojshëm. Prandaj, vendoset si në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim njoftohet:

- z. Labinot Muhaxheri;
- DB;
- Personeli
- arkivi.

Kryetari i Komunës

Abdülhadi Krasnic

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Çikiş - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 33-26
Tarih/Dt. 10.02.2026

ZYRA E KRYETARIT
02 Nr. 33 /26
Me 10.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, lidhur me Ligji nr. 08/l-196 Për Pagat në Sektorin Publik, lidhur me nenin 68 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës lidhur me nenet 74 paragrafi 1 pika 1.7, neni 75 dhe 87 paragrafi 1 i Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr.08/L-197, si dhe nenit 82 të Statutit të komunës së Mamushës dhe lidhur me vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kryetari i Komunës, merr:

VENDIM
Për largimin nga Lista e Pagave

Neni 1
Në bazë të vendimit, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje, të z. Gazmend Gashi, me numër personal 1002828207 largohet nga lista e pagave nga data 15.02.2026, në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Mamushës

Neni 2
Obligohet NjMBNj që, pas nënshkrimit të këtij vendimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për largimin e z. Gazmend Gashit nga lista e pagave dhe përditësimin e të dhënave në sistemin administrativ përkatës.

Neni 3
Ky vendim hyn në fuqi më datë 15.02.2026 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ARSYETIM

z. Gazmend Gashi, i sistemuar në pozitën Udhëheqës i Prokurimit në Komunën e Mamushls, ka paraqitur dorëheqjen e tij me vullnet të lirë, i cila është pranuar me vendimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje. Në përputhje me këtë vendim, marrëdhënia e tij e punës ndërpritet na data 15.02.2026.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, si dhe në rregulloret përkatëse për administrimin e listës së pagave, z. Gazmend Gashi duhet të largohet nga lista e pagës, nga data 15.02.2026 duke reflektuar gjendjen reale të marrëdhënies së saj të punës.

Ky veprim synon të sigurojë përputhshmëri me kornizën ligjore dhe menaxhim të drejtë të burimeve financiare të Komunës.

Njoftohen
1. NJMBNJ.
2. Thesari
3. ARKIVI

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

02 No.Nr. 32-26
Tarih/Dt. 10.02-2026

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
02- Nr.32-26
Me datë 10.01.2026

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), lidhur me me nenet 72, 74 paragrafi 1 pika 1.7, neni 75 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, neni 6 paragrafi 1 pika 1.7 neni 7 të Rregullores (QRK) NR.29/2024 Për Përfundimin E Marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil lidhur me deklaratën e dorëzuar në zyrën e Kryetarit të Komunës për dorëheqje nga marrëdhënia e punës me nr. protokolli 02.Nr-54a-25 të datës 29.08.2025 si dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM
Mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje të nëpunësit civil

Neni I

z. Gazmend Gashi, me numër personal [redacted]7, i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, i sistemuar në vendin e punës dhe detyrat e punës sipas Aktemërimit Udhëheqës i Prokurimit pranë Komunës së Mamushës, të njëjtit i përfundon marrëdhënia e punës në Shërbimin civil me datën 15.02.2026, në bazë të dorëheqjes së tij të paraqitur me vullnet të lirë.

Neni II

Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që, nga data 15.02.2026, ta largojë të lartpërmendurin nga lista e pagave, si dhe të ndërmarrë veprimet përkatëse administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni III

Ky vendim hyn në fuqi më datë 15.02.2026 dhe nga ai moment krijon pasoja juridike për palët e përfshira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ARSYETIM

Z. Gazmend Gashi, me numër personal [redacted]7, nga Komuna e Suharekës, ka ushtruar detyrën e Udhëheqësit të Prokurimit në Komunën e Mamushës, në përputhje me aktemërimin e punës dhe përgjegjësitë e përcaktuara, deri më datën 15.02.2026, kur edhe i ndërpritet marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, bazuar në dorëheqjen e paraqitur me vullnet të lirë.

Dorëheqja është paraqitur përmes shkresës së dorëzuar në Zyrën e Kryetarit të Komunës, e cila është protokolluar me nr. 02.Nr-54a-25 të datës 29.08.2025. Në këtë shkresë, z. Gazmend Gashi ka deklaruar ndërprerjen e marrëdhënies së punës në pozitën Udhëheqës i Prokurimit, duke

theksuar se vendimi është marrë për arsye personale dhe profesionale, në përputhje me të drejtën ligjore për t'u larguar nga Shërbimi Civil me vullnet të lirë.

Marrëdhënia e punës i ndërpritet duke filluar nga data 15.02.2026, në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me respektimin e procedurave të parapara për raste të tilla.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe arsyetimeve të paraqitura në letrën e dorëheqjes, konstatohet se dorëheqja e z. Gazmend Gashi është në përputhje me parimet ligjore dhe standardet administrative.

Prandaj, dorëheqja pranohet dhe për të është marrë vendimi sipas dispozitivit të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala ka të drejtë ankese brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit, pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës

Të njoftohen :
z. Gazmend Gashi
NjMBNj
Arkivi

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamuşa

02 Nr. 31 /26
Me 10.02.2016
Mamushë

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamuša
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 31-26
Tarih/Dt. 10.02.2016

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Për pagesën e Kontrollit Teknik
Neni 1

Lejohet pagesa për operatorin ekonomik Butrinit Sh.P.K, sipas fletëpagesës nr. **0447/26**, për shërbimin e kontrollit teknik të automjetit të tipit Transit Ford me targa 04Z-15-32 nr. Shasisë NM0EXXTTREKM17253.

Neni 2

Mjetet që lejohen për pagesë ndahen nga kategoria "Mallra dhe Shërbime", sipas përshkrimit, "Kontrolli Teknik" i Automjetit Transit Ford me targa 04Z-15-32 nr. Shasisë NM0EXXTTREKM17253." në shumën 30.00 €, për përfituesin: Butrinit Sh.P.K Numri unik i biznesit: **811035030**, Llogaria bankare 1301001002322766, nga blloku kodues 10/626/73850/13954/00000/0721 dhe sipas zotimit 2026-14760.

ARSYETIM

Automjetet që janë në shfrytëzim nga institucionet komunale duhet t'i nënshtrohen rregullisht kontrollit teknik, në përputhje me dispozitat ligjore për sigurinë në komunikacion dhe funksionalitetin teknik të mjeteve motorike. Automjeti i tipit Transit Ford me targa 04Z-15-32 nr. Shasisë NM0EXXTTREKM17253., është pjesë e automjeteve zyrtare të Komunës së Mamushës që është në shërbim të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Mamushës. Kryerja e kontrollit teknik është obligim ligjor dhe parakusht për regjistrimin dhe qarkullimin e ligjshëm të automjetit, andaj realizimi i pagesës për këtë shërbim është i domosdoshëm.

Për këto arsye, është marrë vendimi për lejimin e mjeteve financiare në shumën përkatëse, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohet
1. DSHMS
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOSOVA CUMHURIYETI - REPUBLIKA KOSOVO - MAMUŞA BELEDİYESİ - KOMUNA E MAMUSHËS - OPŠTINA MAMUŠA

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Gelen - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 30-25
Tarih/Dt. 09.02.2026

02 Nr.30/25
Me 09.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 08/l-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjit nr. 03/l-212 i Punës lidhur me nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës mer këtë:

V E N D I M
Për ndryshimin në Listën e Pagave

Neni 1

Znj. Fitore Bytyçi, me Vendimin nr. 02.Nr.287/25, të datës 31.12.2025, është caktuar Ushtruese e Detyrës së Udhëheqëses së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për një periudhë dymbëdhjetë (12) mujore, përkatësisht deri në kthimin e udhëheqëses së rregullt të Burimeve Njerëzore.

Neni 2

Obligohet Zyra e Personelit në Komunën e Mamushës që për të lartcekurën të përcjellë dokumentacionin përkatës në Thesarin e Kosovës – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), me qëllim të ndryshimit në Listën e Pagave, në bazë të Vendimit nr. 02.Nr.287/25, të datës 31.12.2025, duke e sistemuar në kategorinë: Nivel i Ulët Drejtues, klasa: GJ8, koeficienti: 8.16.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Znj. Fitore Bytyçi, e cila deri më tani ka ushtruar funksionin në një pozitë zyrtare të lartë ligjore, me vendim të autoritetit kompetent është caktuar Ushtruese e Detyrës së Udhëheqëses së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Ky caktim është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe procedurat administrative në fuqi dhe, si i tillë, paraqet një lëvizje të brendshme institucionale me karakter të përkohshëm, me qëllim të sigurimit të funksionimit të rregullt, të pandërprerë dhe efikas të njësisë përkatëse.

Me këtë njoftohen

Zyra e Personelit
Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT)
Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Çikiş - Dalese - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 29-26
Tarih/Dt. 09.02.2026

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
02 Nr. 29 -26
Me 09.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Statutit të Komunës së Mamushës 001/2008 e datës 01.12.2008, sipas kërkesës së znj. Lindita Ymeri, Menaxhere për zhvillimin e Kapaciteteve në Asosacionin e Komunave të Kosovës- AKK, për themelimin e Grupit të përfaqësuesve nga Komuna, Kryetari i Komunës me datën 09.02.2026, merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

Themelohet Grupi i përfaqësuesve nga Komuna e Mamushës për zbatimin e aktiviteteve të parapra Projektin ReLOaD3, në këtë përbërje:

1. Çabej Nurkollar- Zyrtar i Lartë Ligjor (Zyra e Kryetarit të Komunës)
2. Neshe Morina- Zyrtare për Shpenzime të Buxhetit(Drejtoria për Buxhet dhe Financa)

Neni 2

1. Grupi i përfaqësuesve nga Komuna do të fillojë bashkërisht zbatimin e aktiviteteve të parapara me projektin ReLOaD3, në përputhje me nenin 1 dhe 9 të Rregullores MF-Nr.-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe metodologjinë LOD. Ekipi i projektit do të bashkëpunojë gjatë gjithë fazave të zbatimit të projektit, do të njoftojë rregullisht Kryetarin me ecurinë e aktiviteteve të projektit, si dhe do t'i kryejë edhe punë të tjera që kërkohen për projektin e cekur.
2. Grupi i përfaqësuesve për zbatimin e aktiviteteve të parapara të projektit ReLOaD3 ka për obligim që të bashkëpunojë me ekipin e projektit gjatë të gjitha fazave të zbatimit.
3. Anëtarët e grupit të përfaqësuesve do të kenë rol në Komisionin Vlerësues të projekt-propozimeve, në Komisionin e Ankesave dhe në Komisionin për Monitorim dhe Raportim të projekteve.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi në ditën e vendimit

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Të Caktuarit
2. Znj. Lindita Ymeri (AKK)
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasnic

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Dalës - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 28-26
Tarih/Dt. 09.02.2026

ZYRA E KRYETARIT
02 Nr. 28 /26
Datë 09.02.2026
Mamushë

Në bazë të nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Mamushë, të datës 01.12.2008 Kryetari i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M
Pagesë për Akomodim

I. Lejohet pagesa e akomodimit për mysafirët e ardhur nga Republika e Turqisë, gjatë vizitës së tyre zyrtare në Komunën e Mamushës, për qëndrimin prej dy (2) netësh, nga data 04.12.2025 deri më 06.12.2025, për dy (2) dhoma të tipit *single*. Pagesa e akomodimit realizohet te Operatori Ekonomik Kaçinari, në bazë të faturës nr. 3, të datës 28.01.2026, në shumën e përgjithshme prej 200.00 euro, për Operatorin Ekonomik me Nr. Unik të Biznesit 810972738, në xhirollogarinë nr. 1502031002243408. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Mysafirët e ardhur nga Republika e Turqisë kanë realizuar vizitë zyrtare në Komunën e Mamushës. Në kuadër të kësaj vizite zyrtare, me qëllim të mikpritjes institucionale dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkomunal, është siguruar akomodimi i tyre për periudhën prej dy (2) netësh, nga data 18.01.2026 deri më 20.01.2026, për dy (2) dhoma të tipit *single*, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Me këtë vendim të njoftohet
1. Drejtorisë Përkatëse;
2. Palëve;
3. Arkiva

Kryetari i Komunës së Mamushës

Abdülhadi Krasniç

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
